



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2004/1 Prot

Tiranë, më 12.07.2023

**VENDIM**

**Nr. 32, datë 12.07.2023**

**PËR**

**RRËZIMIN E ANKESËS**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 2004 Prot., datë 30.06.2023, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Klubit të Futbollit Tirana sh.a.

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 07.05.2023, depozituar në adresën elektronike [info@kftirana.al](mailto:info@kftirana.al), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Sa janë pagesat e përfituara nga anëtarët e bordeve të mbikëqyrjes?*
2. *Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve në bordin e mbikëqyrjes pranë jush?*
3. *Sa është buxheti për bordet e mbikëqyrjes?*
4. *Përse nuk bëhen transparente mbledhjet e bordit mbikëqyrës dhe sa here në muaj mblidhen këto borde në institucionin tuaj?*

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi Klubi i Futbollit Tirana sh.a., nuk ka kthyer përgjigje për sa është kërkuar, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë

Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit “*Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi....*”, si dhe gërmës “b” të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative*” ka verifikuar statusin juridik të subjektit ndaj të cilit kërkohet fillimi i procedurës administrative Klubit të Futbollit Tirana sh.a.

Nga verifikimi paraprak, Klubi i Futbollit Tirana sh.a, është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik i identifikimit të subjektit L 12220027 I. Referuar ekstraktit të Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se Klubi i Futbollit Tirana sh.a., është një shoqëri aksionare, me 34% aksione të Bashkisë Tiranë dhe 66% aksione private.

Objekti i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar “*Autoritet publik*”:

*a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.*

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Klub i Futbollit Tirana sh.a., nuk është autoritet publik, në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitimit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës nr. 2004 Prot., datë 30.06.2023, të kundër Klubit të Futbollit Tirana sh.a., me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 12.07.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**